



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 14, Datë 27.01.2023**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “TPLANI HC”  
SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
HIDROCENTRALI “VALBONA”, NË LUMIN E VALBONËS, BASHKIA TROPOJË,  
ME KAPACITET TË INSTALUAR 2300 KW**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.01.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 99/3 prot., datë 25.01.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “TPLANI HC” shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Valbona”, në lumin e Valbonës, Bashkia Tropojë, me kapacitet të instaluar 2300 KW”,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria “TPLANI HC” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 99, datë 13.01.2022, ka paraqitur aplikimin për pajisjen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentrali “Valbona”, në lumin e Valbonës, Bashkia Tropojë, me kapacitet të instaluar 2300 kW.

- Me e-maillet e dërguara dhe të protokolluara në ERE me nr. 99/1 prot., datë 19.01.2022 dhe nr. 99/2 prot., datë 19.01.2022, shoqëria ka depozituar dhe dokumente shtesë në kuadër të këtij aplikimi.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); Shtojcën 1, Shtojcën 1A dhe Shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (Aneksi A).
- Aplikuesi ka kryer pagesën, sipas përcaktimeve të Aneksit A “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “TPLANI HC” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin si në zbatim të nenit 9 të rregullores për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmen “c” dhe për pikën 2, gërmat “b”, “e” dhe “f”.
- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dokumentacioni si vijon:

## **NENI 9**

### **Formati dhe dokumentacioni për aplikim**

#### **Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë**

##### *Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ*

- **gërma “b”**: Aplikuesi duhet të depozitojë vërtetimin e gjendjes gjyqësore për vetë shoqërinë “TPLANI HC” sh.p.k.
- **gërma “c”**: Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE strukturën organizative, së bashku me stafin teknik që do të angazohet për me prodhimin e energjisë elektrike.

##### *Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*

- **gërma “a”**: Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve.
- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE pasqyrat financiare për vitet 2019-2021, si dhe pasqyrat paraprake të viti 2022. Gjithashtu, shoqëria duhet të depozitojë

informacionin/dokumentacionin përkatës në kuadër të zbatimit të nenit 11 të Kontratës së Koncesionit, ku përcaktohet procedura dhe afati për të kryer testimin e veprës.

### **Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës**

Pika 2.1 Për t'u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- **gërma “a”**: Shoqëria duhet të plotësojë të dhënat në lidhje me llojin e HEC-it, numrin e njësive gjeneruese, vitin e ndërtimit dhe datën e fillimit të operimit.
  - **gërma “b”**: Shoqëria duhet të informojë ERE-n në rast se ndryshimet e kuotave që kanë ndodhur në strukturën e shoqërisë përgjatë viteve kanë afektuar këtë kontratën e koncesionit të nënshkruar me METE-n.
  - **gërma “c”**: Shoqëria duhet të sqarojë/saktësojë përse kërkesa për pikën e lidhjes është bërë për kapacitetin e instaluar 2100 kW, ndërkohë që në Kontratën e Koncesionit fuqia e instaluar është 2300 kW; duhet të sqarojë pse kërkesa dhe më pas miratimi i pikës së lidhjes është bërë për koncesionarin; të bëjë me dije nëse pika e lidhjes ka ndryshuar.
  - **gërma “d”**: Shoqëria duhet të sqarojë statusin e lejes për përdorimin e burimit ujqor përkatës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC Valbona.
- 
- Kontrata e Koncesionit nr. 279 rep., nr. 38 kol., datë 29.01.2009, ka një afat 35-vjeçar, por sqarojmë se ERE në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, nuk mund të japë një licencë me afat më të madh se 30 vjet për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Sa konstatohet nga llogaritja e afateve, duke filluar nga data e nënshkrimit të Kontratës së Koncesionit sipërcituar, rezulton se shoqëria ka humbur afërsisht 14 vjet nga periudha koncesionare dhe periudha e mbetur për licencim është 16 vjet. Gjithsesi, në rast licencimi të shoqërisë, në fazën përfundimtare do të bëhet përllogaritja e afateve që i mbeten nga periudha koncesionare.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “TPLANI HC” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Valbona”, në lumin e Valbonës, Bashkia Tropojë, me kapacitet të instaluar 2300 kW, për një afat 16-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**